




REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna Drenas

Drejtoria Komunale për Arsim

09 Nr. 11/01-4697, dt. 31/01 2022



Në bazë nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Nenit 5 (shkronja c) të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Rep. së Kosovës Nr. 03/L-068, Nenit 17 (shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Nenit 35 të Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar në Rep. e Kosovës Nr. 04/L-032, neni 7 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ 10/2018 për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimin administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, si dhe në bazë të kërkesave të institucioneve arsimore, Drejtoria Komunale e Arsimit në Drenas, shpall:

Konkurs për plotësimin e vendeve të lira të punës për vitin shkollor 2022

1. Sh. F. M. U. „Hasan Prishtina” Llapushnik, Sh. F. M. U. „Shaban Polluzha” Korroticë e Lartë, si dhe Sh. F. M. U. „Abedin Bujupi” Arllat
 - *Një asistent për fëmijë/ nxënës me nevoja të veçanta*
2. Shkolla fillore e mesme e ulët „Zenel Hajdini” Qëndresa I, si dhe Shkolla fillore e mesme e ulët „ Ali Gashi” Çikatovë e Re dhe Sh. F. M. U. „Gani Elshani” Krojkovë
 - *Një asistent për fëmijë/ nxënës me nevoja të veçanta*
3. Sh. F. M. U. „ Luigj Gurakuqi” Sankoc, Sh. F. M. U. „ 24 Korriku” Fushticë e Ulët,
 - *Një asistent për fëmijë/ nxënës me nevoja të veçanta*

Punët dhe detyrat për asistent/e për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore

- Ndhmon fëmijët/nxënësit në zhvillimin dhe promovimin e pavarësisë, orientimin dhe mobilitetin, ndihmon në vendosjen në klasë dhe dorëzimi I fëmijes te personi familjar që e përcjell atë, në oborrin e shkollës.
- Punon me mësimmshënësit dhe stafin tjetër për zbatimin e PIA-s, lëndë të individualizuara ose mësim në fusha të aktiviteteve;
- Përgatitë materiale mësimore si dhe menaxhon me pajisjet e nevojshme brenda dhe jashtë klasës;
Vëzhgon dhe dokumenton vështirësitë dhe nevojat e identifikuara të fëmijëve, përgatitë informata kthyesë për vështirësitë dhe arrijtet e fëmijëve;
- Promovon arsimin gjithëpërfshirës dhe pranimin e të gjithë fëmijëve në klasë, inkurajon fëmijët në komunikim për pjesëmarrje në lojë, stimulimin e të folurit të gjuhës përmes bisedës dhe lojës;

- Mbikëqyrë dhe ndihmon fëmijët/nxënësit gjatë racioneve ushqimore, kujdeset për nevojat fizike dhe mjekësore të nxënësve dhe asiston në veshjen dhe pastërtinë e përgjithshme të tyre;
- Planifikon me mësues programin ditor dhe javor për mësim, aktivitete dhe ngjarje me qëllim të mbështetjes së fëmijëve për mësim;
- Promovon bashkëpunimin shkollë-shtëpi, mbështetë dhe diskuton çështje të ndjeshme me prindin/kujdestarin;
- Respekton rregullat dhe etikën e shkollës, sjelljet e mira ndaj nxënësve;
- Prezanton punën dhe arritjet e nxënësve.
- Informacionet në shkollë i trajton si plotësisht konfidenciale;

Kushtet: Për vendet e punës, në këto nivele (shkolla fillore, shkolla të mesme të ulëta dhe shkolla të mesme të larta) kandidatët duhet ta kenë të kryer drejtimi përkatës sipas Normativit 10/2018, shkolla e mesme dhe niveli i 5 –të (postsekondar) i kualifikimit, asistent për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Zgjedhja e kandidatëve për mësimdhënës-asistent do të bëhet në bazë të nenit 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, UA 10/2018 si dhe në bazë të rezultateve të panel-intervistës, me shkrim dhe me gojë.

Në intervistë me shkrim ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit sipas Udhëzimit administrativ nr. 10/2018 për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm.

Për konkurrim, kandidatët duhet të plotësojnë dokumentacionin :

- Diploma origjinale ose kopja e vërtetuar e diplomës origjinale,
- Kopja e letërnjoftimit;
- Çertifikata origjinale që nuk është nën hetime, ose e noterizuar, jo më të vjetër se gjashtë(6) muaji
- Certifikatën e gjendjes shëndetësore (në rast se pranoheni)
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në objektin e Komunës, kati i parë, sporteli nr 10, 12
- Kandidatët mund të konkurrojnë vetëm për një(1) institucion, gjegjësisht për një(1) pozitë në njërin prej pikave(1.2.3)

Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara nga MASHT.

Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim.

Rezultatet e konkursit do të shpallen në web-faqe të Komunës së Drenasit.

Dokumentacioni nuk kthehet.

Data e njoftimit në webfaqen unike të procedurave të konkurimit <https://konkursi.rks-gov.net> është prej dt. 31.01.2022 deri me dt.01.03.2022, **ndërsa data e aplikimit është nga data 02.03.2022 deri me datën 09.03.2022.** Përveç web faqës unike të procedurave të konkurimit, konkursi publikohet edhe në web-faqe zyrtare të Komunës.

Drejtori i Arsimit:

Muhamet Gjoka

